



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:144984

Datë: 08.03.2023

Numri i dokumentit: 04057509

C.nr.1009/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim Balaj, me bashkëpunëtorin profesional Zef Qupi në çështjen e paditësve G. K., Gj., F., M. Rr., V. A. dhe Z. K. që të gjithë nga Gjakova të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë Fitim Gashi, avokat në Prishtinë dhe Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, Rr."Fehmi Agani" Hy-25/4 – Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Gjakovë, lidhur me çështjen juridike kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, shpenzimeve të udhëtimit dhe për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 9,293.00 euro, jashtë seancës, me 08 mars 2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve G. K., Gj., F., M. Rr., V. A. dhe Z. K., që të gjithë nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që:

-Paditësit G. K., në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim (shujta ditore) për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me datë 23.04.2021, për 106 ditë të prezencës në punë të ia paguajë shumën prej 212.00 euro,

-Paditëses Gj., F., që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim (shujta ditore) për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me datë 23.04.2021, për 106 ditë të prezencës në punë të ia paguajë shumën prej 212.00 euro, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit në punë për periudhën nga data 05.07.2018 e deri me datë 31.01.2021 në vlerë të 70% për 432 ditë të ia paguajë shumën prej 302.40 euro, në shumë të përgjithshme prej 514.40 euro,

-Paditëses M. Rr., që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim (shujta ditore) për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me datë 23.04.2021, për 133 ditë të prezencës në punë të ia paguajë shumën prej 266.00 euro,

-Padiësës V. A., që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim (shujta ditore) për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me datë 23.04.2021, për 133 ditë të prezencës në punë të ia paguajë shumën prej 266.00 euro,

-Padiësit Z. K., që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim (shujta ditore) për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me datë 23.04.2021, për 132 ditë të prezencës në punë të ia paguajë shumën prej 264.00 euro, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit në punë për periudhën nga data 05.07.2018 e deri me datë 31.01.2021 në vlerë të 70% për 432 ditë të ia paguaj shumën prej 907.20 euro, në shumë të përgjithshme prej 1,171.20 euro

II. DETYROHET e paditura që padiësve të lartcekur të iu paguaj kamatën ligjore 8%, e cila do të llogaritet nga data 05.07.2021 (data e paraqitjes së padisë) e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale në shumën prej 644.00 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadiës së padiësëve lidhur me kërkesën për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit dhe atë për padiësin G. K. në shumën prej 1,715.85 euro, për padiësen Gj., F. shumën prej 1,715.85 euro, për padiësen M. Rr. shumën prej 1,715.85 euro, si dhe për padiësin Z. K. shumën prej 1,715.85 euro, si e pabazuar.

A r s y e t i m

Padiësit në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tyre kanë ushtruar padi me datë 05.07.2021, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në Gjakovë, të cilën e ka precizuar me datë 05.12.2022, më të cilën kanë kërkuar që të obligohet e paditura, që padiësit G. K., t'ia kompensojë shumën prej 240.00 euro, dhe atë në emër të ushqimit në punë për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me 23.04.2021, për secilën ditë prezentë në punë nga 2 (dy) euro, për 106 ditë pune, në emër të kualifikimit arsimor shumën prej 1,715.85 euro. Padiësës Gj., F. t'ia kompensojë shumën prej 212.00 euro, dhe atë në emër të ushqimit në punë për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me 23.04.2021, për secilën ditë prezentë në punë nga 2 (dy) euro, për 106 ditë punë, në emër të shpenzimeve të udhëtimit në punë për periudhën nga data 05.07.2018 e deri me datë 31.01.2021 në vlerë të 70% për 432 ditë të ia paguaj shumën prej 302.40 euro, dhe në emër të kualifikimit arsimor shumën prej 1,715.85 euro. Padiësës M. Rr. t'ia kompensojë shumën prej 226.00 euro, dhe atë në emër të ushqimit në punë për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me 23.04.2021, për secilën ditë prezentë në punë nga 2 (dy) euro, për 133 ditë, dhe në emër të kualifikimit arsimor shumën prej 1,715.85 euro. Padiësës V. A. t'ia kompensojë shumën prej 266.00 euro, dhe atë në emër të ushqimit në punë për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me 23.04.2021, për secilën ditë prezentë në punë nga 2 (dy) euro, për 133 ditë pune si dhe padiësit Z. K. t'ia kompensojë shumën prej 264.00 euro, dhe atë në emër të ushqimit në punë për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me 23.04.2021, për secilën ditë prezentë në punë nga 2 (dy) euro, për 132 ditë punë, në emër të shpenzimeve të udhëtimit në punë për periudhën nga data 05.07.2021 e deri me datë 31.01.2021 në vlerë të 70% për 432

ditë të ia paguaj shumën prej 907.20 euro, dhe në emër të kualifikimit arsimor shumen prej 1,715.85 euro.. Në padi kanë parashtruar se e paditura në bazë të nenit 35 par.5 dhe 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.01/B, nr. prot 105, e datës 22.01.2021, ka obligim që të iu kompensoj paditësve ushqimin gjatë orarit të punës dhe atë 2.00 euro për çdo ditë të paraqitur në punë, si dhe sipas KKAK, neni 7 i kësaj kontrate përcakton se punëtorëve arsimor iu takon përqindja për kualifikim nga paga bazë dhe që nga koha e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate e deri më tani nuk është realizuar neni 7 i saj asnjëherë, duke bërë kështu që kontrata kolektive të mos ekzekutohet në tërësi. Kanë parashtruar se nga koha e hyrjes në fuqi e kontratës kolektive të arsimit e deri me tani, kjo kontratë nuk është ekzekutuar në tërësi, e për këtë kanë propozuar që kërkesëpadia e paditësve e precizuar me datë 05.12.2022 të aprovohet në tërësi. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Gjakovës përmes të autorizuarit të saj në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 20.06.2022, nder të tjera ka parashtruar se e kundërshtojnë në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetimin se me dispozitat kalimtare të nenit 45 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë datë 22.01.2021, është paraparë që MASH, SBASHK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për ti informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studenteve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për zbatimin e dispozitës së nenit 35, paragrafët 5, 7 dhe 11, kur të krijohen mundësitë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo me vonë se viti 2023. Po ashtu e paditura është thirrur edhe në institutin e parashkrimit, ku ka theksuar se: sipas nenit 87 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tre (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqësore të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nuk është kontestues se paditësit janë të punësuar tek e paditura, e po ashtu nuk ishte kontestuese se pagimi i shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit dhe kualifikimit për periudhën e kërkuar nuk iu është ekzekutuar.

Kontestuese mbetet pamundësia financiare për pagimin e këtyre kompensimeve nga ana e të paditurës në drejtim të tani paditësve, e që në këtë rast gjykata u lëshua vetëm në vërtetimin e faktit kontestues në këtë procedurë.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja

në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, andaj, duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit ta kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, e lidhur me 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”, ndërsa paragrafi 5 i po këtyre kontratave, të Kontratës Kolektive të Arsimit e datës 18.04.2017 dhe të asaj të datës 22.01.2021, në mënyrë të njëjtë është paraparë se: “Mësimdhënësit që udhëtojnë në vendbanimet e Komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”. Andaj gjykata erdhi në përfundim se paditëseve ju takon shuma si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë duke bërë përlllogaritjen e secilës ditë të prezencës në punë, me shumën që ju takon sipas dispozitës së lartcekur, në shumë prej 2.00 euro për një ditë pune, si dhe 70% e trafikut urban, pasi që nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë, të lëshuar nga SHMM “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 365/2021, i datës 23.04.2021, vërtetohet se paditësi G. K. ka vijuar 106 ditë pune, për shpenzime të ushqimit në punë, paditësja Gj. F. ka vijuar 106 ditë pune, e cila vërtetohet nga vërtetimi i lëshuar nga SHMM “Selman Riza” në Gjakovë me numër të protokollit 366/2021 i datës 23.04.2021 si dhe nga vërtetimi i lëshuar nga SHMM “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 320/21 i datës 18.02.2021 vërtetohet se paditësja ka vijuar 602 ditë pune, çmimi i biletës sipas Shoqatës së Transporti për relacionet Skivjan-Gjakovë ku paditësja ka udhëtuar kushton 0.50 euro për një drejtim. Paditësja M. Rr. ka vijuar gjithsej 133 ditë pune, e cila vërtetohet nga vërtetimi i lëshuar nga SHMM “Selman Riza” në Gjakovë me numër të protokollit 374/2021, i datës 23.04.2021 për shpenzime të ushqimit në punë. Paditësja V. A. ka vijuar gjithsej 133 ditë pune, e cila vërtetohet nga vërtetimi i lëshuar nga SHMM “Selman Riza” në Gjakovë me numër të protokollit 383/2021, i datës 23.04.2021 për shpenzime të ushqimit në punë. Paditësi Z. K. ka vijuar 132 ditë pune, e cila vërtetohet nga vërtetimi i lëshuar nga SHMM “Selman Riza” në Gjakovë me numër të protokollit 386/2021 i datës 23.04.2021 si dhe nga vërtetimi i lëshuar nga SHMM “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 315/21 i datës 02.02.2021 vërtetohet se paditësi ka vijuar 602 ditë pune, çmimi i biletës sipas Shoqatës së Transporti për relacionet Sopot – Gjakovë kushton 1.00 euro për një drejtim dhe për relacionet Gjakovë-Dardani kushton 0,50 cent një drejtim.

Në neni 329 par. 1 të LPK-së parashihet që: “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj provave që kishin të bënin me vërtetimin e fakteve (ditët e pranisë në punë, vendbanimin e

paditëses dhe lartësinë e kërkesës), gjykata i'u fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Sa i përket pjesës refuzuese si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e refuzoi kërkesën e paditëseve ngase gjykata duke analizuar rregullativën ligjore erdhi në përfundim se licencimi i mësimdhënësve është promovuar si synim strategjik i Autoriteteve Arsimore të Kosovës, me qëllim të përmirësimit të mësimdhënies me shpenzime publike, duke synuar motivimin e ngritjes së nivelit të kualifikimit të stafit të mësimdhënësve, që kanë qenë në progres mësimor e që do të hyjnë në këtë proces, e si i tillë përfshirja e licencimit në nenin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është e karakterit deklarativ, pra kjo dispozitë nuk krijon raport obligativ për kompensim por vetëm detyrim të ngritjes kualitative. Nisur nga kjo edhe në vetë Kontratën Kolektive, çështja e licencimit nuk është përfshirë në pjesën obliguese si në nenin 35 ku janë përcaktuar edhe detyrimet për kompensim. Përkundrazi në pikën 3 të nenit 35, përcaktohet se: *“Pagat e punëtorëve, punëtorëve të sistemit të arsimit përcaktohen me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Për ndryshimet dhe shtesat, plotësimet dhe rritjet e mëtejshme të pagave të punonjësve të sistemit të arsimit, punëdhënësi është i detyruar që në procesin e hartimit të buxhetit për çdo viti të konsultohet dhe të marr mendimin e SBASHK-ut, nënshkruese e kësaj kontrate Kolektive të Arsimit në Kosovë, përpara se propozimet përkatëse të dorëzohen në Qeveri për miratim”*. Ndërsa po në nenin 35, qartazi në pikat 4 deri në 10, përcaktohen rregullat e përgjithshme dhe pagat si dhe obligimet financiare, ku në mënyrë të qartë parashihet kompensimi për orët shtesë, shpenzimet e udhëtimit, shtesa për përvojën e punës, shujta, paga jubilarë e përcjellëse dhe përfshirja e inflacionit të pranuar nga Enti i Statistikave, por jo edhe licencimi dhe obligimi i pagesës në shkallë siç deklarohet në nenin 7, për çka gjykata e morri si të bazuar pretendimin e të paditurës për mungesë dhe mos planifikim të buxhetit lidhur me kualifikimin arsimor siç përcaktohet me nenin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit. Gjkata konsideron se neni 7 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nuk ka karakter imperativ dhe si i tillë nuk e obligon asnjërin nga subjektet e përfshira në procesin e licencimit. Për më tepër këtë detyrim nuk e parasheh as UA, ku në nenin 17 janë përcaktuar punët dhe detyrat e secilit nga 9 faktorët e pjesëmarrjes në licencim. Në asnjërin nga detyrat e faktorëve nuk parashihet obligimi taksativ për të ngritur pagat në shkallën siç deklarohet në nenin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Si rrjedhojë, nuk ka raport kontraktual në mes të palëve ndërgjyqëse apo dispozitë të karakterit obligativ që krijon të drejtën për paditësit e cila do të krijonte detyrimin për të paditurën që të kompensonte të njëjtin për këtë kriter të kompensimit, për çka gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara*

në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Gjykata ka vlerësuar edhe vendimin e bashkëngjitur me parashtresën e datës 15.12.2022, i cili mban numër 01/33, datë 29.08.2008 (në versionin e fotokopjuar), mirëpo edhe në këtë drejtim kërkesëpadia e paditësve ishte pa mbështetje, pasi që nga përmbajtja dhe detyrimet që dalin nga ky vendim, përkatësisht në pikën 8 të këtij vendimi, është përcaktuar se *“Për zbatimin e këtij*

vendimi obligohen Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike”. Pra, detyrimi i cili del nga ky vendim, assesi nuk është i drejtuar tek punëdhënësi i këtu paditësve, apo komunat në nivel të vendit, por ekskluzivisht është i drejtuar për vartësit e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ministrinë e lartcekura. Andaj, përfundimisht gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësve edhe sipas kësaj baze në raport me të paditurën Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit është e pabazuar.

Ndërsa kundërshtimin e të paditurës lidhur me mungesën e mjeteve buxhetore, sa i përket shpenzimeve lidhur me ushqimin dhe shpenzimet e udhëtimit në punë, gjykata e vlerësoj të pambështetje, pasi që zbatueshmëria e kontratave kolektive të arsimit në Kosovë, ajo e datës 18.04.2017, si dhe e datës 22.01.2021, është paraparë saktësisht në nenin 2 të tyre, andaj për gjykatën ky pretendim ishte jo relevant për vendosje ndryshe.

Gjykata lidhur me kamatën ka vendosur duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së, llogaritja e kamatës është bërë nga data e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, është marrë sipas nenit 449 dhe 452 par. 2 të LPK-së, me ç’rast paditësve iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 644.00 euro. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00 euro, (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), si dhe për përpilimin e padisë shumë prej 624.00 euro, (e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Sa i përket kompensimin të shpenzimeve për përpilimin e parashtresës së datës 05.12.2022, gjykata e refuzoj si të pabazuar pasi që në precizimin e parashtruar paditësit nuk patën sukses në këtë drejtim, gjegjësisht në raport me kërkesëpadinë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit arsimor, si dhe këto shpenzime janë krijuar pa fajin e të paditurës.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1009/21, me 08 mars 2023

GJYQTARI
Durim BALAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.